



3220  
28.06.2016

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.Regj. Themeltar 8794/4168/1906

Nr. 1703 Vendimi

Date 30.10.2014

Date 16.06.2016

**V E N D I M**

**“NE EMER TE REPUBLIKES”**

Gjykata Administrative e Apelit e perbere nga gjyqtaret :

**KRYESUES : ARTUR MALAJ**

**ANETARE : FJORALBA PRIFTI**

**ANETARE : BLERONA HASA**

asistuar nga sekretare gjyqesore Ermelinda Nuraj, ne dhome keshillimi te dates 16.06.2016,  
mori ne shqyrtim çeshjen qe u perket paleve :

**PADITES :** Subjekti “Qazim Koxhaj” me NIPT K32508036D dhe  
perfaqesues ligjor Z.Qazim Koxhaj.

**TE PADITUR :** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat  
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane

**OBJEKTI :** Anullimin (Shfuqizimin) teresisht te aktit administrativ, te Njoftim  
vleresimit nr.906 prot. date 11.03.2014 te DRT Berat.  
Anullimin (Shuqizimin) teresisht te aktit administrativ, vendim  
nr.7535/4 prot., date 13.05.2014, te leshuar nga Drejtoria e  
Apelimit Tatimor ne DPT Tirane.

Detyrimin e te paditurit t'i ktheje paditesit shumen e lekeve qe jane paguar nga paditesi per detyrimin e TVSH<sup>se</sup>, gjobe, kamatvonesa etj..., si kusht per t'u pranuar per shqyrtim ankimi administrativ. Shpenzimet gjyqesore dhe per avokatet te paguhen nga ana e paditur.

**BAZA LIGJORE** : Nenet 31, 32 e vijues dhe 324 e vijues te K.Pr.Civile; Ligji Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise"; Ligji nr.9109, date 17.07.2003; Ligji nr.91, date 27.09.2012 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin per avokatin ne Republiken e Shqiperise"; Kodi i Procedurave Administrative; neni 106 e vijues te K.Pr.Civile.

**Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore me vendimin Nr. 1166, dt. 23.07.2014, ka vendosur:**

- Rrezimin e kerkesepadise si te pa bazuar ne ligj dhe ne prova.
- Shpenzimet gjyqesore pales inicuese te ketij gjykimi.

**Kunder vendimit Nr. 1166, dt. 23.07.2014, te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore, ka paraqitur ankim pala paditese, z. Qazim Koxhaj, qe kerkon prishjen e vendimit dhe pranimin e kerkesepadise sipas objektit te saj, duke parashtruar keto shkaqe:**

- Raport kontrolli perfundimtar date 28.2.2014, njoftim vleresimi per detyrimet tatimore Nr. 906 date 11.3.2014, vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor ne DPT Tirane me Nr. 7535/4, date 13.05.2014, vendimi i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore me Nr. 1166, date 23.07.2014, jane rrjedhoje e interpretimit te gabuar qe i behet neni 11 te Ligjit "Per avokatin ne R.SH" me Nr. 9109, date 17.07.2003, i ndryshuar me Ligjin Nr. 91, i cili ka hyre ne fuqi ne daten 17.10.2012, dhe si te tilla keto vendime duhet te prishen dhe te pranohet kerkesepadia.
- Kontrolli tatimor ndaj subjektit Qazim Koxhaj ka filluar ne daten 8 nentor 2013 dhe perfshinte vitet 2010, 2011, 2012, 2013, per keto kater vjet qe eshte ushtruar kontroll tatimor, neni 11 per kete periudhe kontrolli ka pesuar ndryshime, pasi per menyren e shperblimit te punes se avokatit per periudhen e kontrollit per vitet 2010, 2011, dhe deri

ne daten 17 Tetor 2012 ne kohe dhe ne hapesire, ka vepruar Ligji Nr.9109, date 17.07.2003, si dhe persa i perket nenit 11 menyres se shperblimit te punes, ne zbatim te ketij ligji ka dale dhe Urdheri i Ministrit te Drejtesise dhe Kryetarit te Dhomes Kombetare te Avokatisë te Shqiperise me nr. 1284/3, date 16.03.2005. Sipas Ligjit Nr. 9109, date 17.7.2003, neni 11 thuhet: *"shperblimi i avokatit per punen e kryer eshte me marreveshje, ndermjet tij dhe pales se mbrojtur ose te perfaqesuar prej tij, nga gjykata ose prokuroria, kur ai eshte caktuar kryesisht ose kur personi i mbrojtur ose i perfaqesuar nuk ka mundesi financiare dhe ndihma ligjore per te eshte falas. Masa e shperblimit per keto raste percaktohet me vendim te perbashket te Ministrit te Drejtesise dhe Keshillit Drejtues te Dhomes Kombetare te Avokatisë"*. Sipas Urdherit te Ministrit dhe Kryetarit te Dhomes Kombetare te Avokatisë me Nr.1284/3, date 16.03.2005 parashikohet se: *"Tarifat e mesiperme zbatohen, vetem kur nuk ka marreveshje ndermjet paleve per shperblimin e sherbimit te avokatisë, avokati detyrohet te zbatoje tarifat sipas urdherit te permendur me siper"*.

- Ndermjet subjektit tatimor avokat Qazim Koxhaj dhe klienteve te ndryshem te mbrojtur ose te perfaqesuar prej ketij subjekti, ka pasur marreveshje verbale (gojore), e provuar kjo dhe nga raporti perfundimtar i inspektorit tatimor, i cili sqaron se subjekti tatimor Qazim Koxhaj ka deklarur shitje per cdo vit qe eshte kontrolluar 2010, 2011, 2012, 2013 dhe per cdo shitje ka leshuar fature shitje TVSH, se ciles i ka bashkelidhur dhe kuponin tatimor te leshuar nga pajisja fiskale. Nga krahasimi elektronik i te dhenave dhe deklarimeve ato jane ne rregull dhe nuk ka mosperputhje etj, gje qe tregon se ka patur marreveshje verbale (gojore) ndermjet avokatit Qazim Koxhaj dhe klienteve te mbrojtur apo perfaqesuar prej tij. Ne rast se subjekti nuk do te kishte realizuar shitje, te cilat i ka deklaruar per vitet qe eshte ushtruar kontrolli 2010, 2011, 2012, 2013, nuk do te kishte leshuar fatura shitje TVSH, nuk do ti kishte bashkalidhur kuponin tatimor nga pajisja fiskale, nuk do te kishte paguar brenda afateve ligjore detyrimet ne banke, vetem ne keto raste kur nuk do te kishte nje marreveshje te tille gojore ndermjet avokatit dhe klienteve te mbrojtur apo te perfaqesuar prej tij, vetem atehere duhej te penalizohej dhe te kerkohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat te zbatoheshin tarifat sipas Urdherit te Ministrit te Drejtesise me nr.1284/3, date 16.3.2005, por e verteta eshte se per vitet 2010, 2011 dhe deri ne daten 17 Tetor 2012, kur ka hyre ne fuqi Ligji Nr.91, per ndryshimet qe i jane

bere nenit 11, ai ka realizuar marreveshjen verbale (gojore) me klientet e perfaqesuar apo mbrojtur.

- Per periudhen e kontrollit te mbetur nga data deri ne daten 8 Nentor kur ka filluar kontrolli tatimor, per kete periudhe ka vepruar Ligji Nr. 91, date 17.10.2012, neni 11 i ndryshuar sipas te cilit: *"Ministri i Drejtesise dhe Kryetari i Dhomes Kombetare te Avokatisë pasi marrin mendimin e Ministrise se Finanacave, caktojne tarifat e shperblimit te avokateve per dhenien e ndihmes juridike, te cilat zbatohen kur nuk ka marreveshje te ndryshme me shkrim mes avokatit dhe personit te mbrojtur ose te perfaqesuar prej tij"*. Subjekti nuk e ka shkelur Ligjin nr.9109, date 17.07.2003, neni 11, per periudhat kohore kur ai e ka shtrire efektin e tij ne kohe dhe ne hapesire per periudhen e kontrollit 2010, 2011 deri ne daten 17.10.2012, kur ka hyre ne fuqi ligji me nr. 91, date 17.9.2012.
- Edhe persa i perket periudhes tjeter te kontrollit te mbetur nga data kur ka hyre ne fuqi Ligji Nr.91, deri ne daten e fillimit te kontrollit, 1 nentor 2013, subjekti tatimor avokat Qazim Koxhaj nuk e ka shkelur ligjin, pasi pas daljes se Ligjit Nr.91, date 17.9.2012, Ministri i Drejtesise dhe Kryetari i Dhomes Kombetare te Avokatisë se R.Sh nuk kishte nxjerre urdher per te caktuar tarifat per shperblimin e punes se avokateve deri ne daten 8 nentor 2013, kur ka filluar kontrolli tatimor. Ne keto kushte per periudhen 17.10.2012, kur ka hyre ne fuqi Ligji Nr.91, date 17.9.2012 nuk mund te zbatohen tarifat e Urdherit te Ministrit te Drejtesise dhe Kryetarit te Dhomes Kombetare te Avokatisë me Nr. 1284/3, date 16.3.2005, pasi si Ligji Nr. 91, date 17.9.2012, ashtu dhe Urdheri i Ministrit te Drejtesise dhe Kryetarit te Dhomes Kombetare te Avokatisë me Nr. 1284/3, date 16.3.2005 nuk kane fuqi prapavepruese.

## GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi degjoi relatimin e gjyqtarit Artur Malaj ne dhome keshillimi:

VEREN

### ***Rrethanat e faktit :***

Paditesi Qazim Koxhaj e ushtron profesionin e lire te avokatit qysh prej muajit shkurt 1997 e ne vazhdim pa nderprerje.

Ne 8 Nentor 2013 ndaj tij eshte ushtruar kontroll tatimor nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat per vitet 2010, 2011, 2012, 2013, per bilancet, per sigurimet shoqerore, shendetesore, TVSH etj. Nga raport kontrolli i mbajtur nga inspektori i Drejtorise Rajonale Tatimore Berat, i ngarkuar me kete kontroll, ka rezultuar se ne lidhje me llogaritjen dhe derdhjen e kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe te ardhurave nga punesimi per periudhen Janar 2010, tetor 2013, nga ana e inspektorit eshte bere verifikimi i deklaratave. Per sa i perket veprimeve aritmetike nuk rezultuan gabime, bazuar ne dokumentacionin vene ne dispozicion prej subjektit tatimor, avokat Qazim Koxhaj, duke u bere krahasimi i listepagesave me formularet e deklarimit, por per vitet 2010, 2011, 2012, 2013 sipas pales se paditur ka shkelje ne lidhje me zbatimin e nenit 11 te Ligjit nr.9109, date 17.07.2003 "Per profesionin e avokati ne R.Sh", i ndryshuar me Ligjin nr. 9795, date 23.07.2007 dhe Ligjin nr. 10047, date 24.12.2008.

Sipas pales se paditur ne asnje rast ndermjet Z. Qazim Koxhaj, si avokat dhe pales se marre ne mbrojtje apo perfaqesim nga ana e tij nuk ka marreveshje per masen e shperblimit per punen e kryer, sipas raportit te inspektorit tatimor, per pasoje paditesi eshte penalizuar me detyrime shtese dhe gjoba ne vleren 367.705 leke.

Paditesi ka ezauruar rrugen e ankimit administrativ prane Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane, e cila me vendim nr.7535/4 prot., date 13.05.2014 ka lene ne fuqi aktin administrativ me nr.906, date 11.03.2014 nxjerre nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat.

### ***Pretendimet e pales paditese :***

Pala paditese ka pretenduar se, kontrolli i ushtruar ndaj tij prej Drejtorise Rajonale Tatimore Berat, sipas programit te miratuar nga vete kjo drejtori, per vitet 2010, 2011, 2012, 2013, ne pergjithesi ka rezultuar i rregullt, me perjashtim te faktit se sipas inspektorit te tatimeve, subjekti ka bere shkelje te nenit 11 te Ligjit nr.9109, date 17.07.2003, i ndryshuar me Ligjin nr. 9795, date 23.07.2007 dhe Ligjin nr. 10047, date 24.12.2008.

Pala paditese ka pretenduar se, ne kete pike te raportit qe inspektori tatimor e ka penalizuar, kemi nje interpretim te gabuar te nenit 11 te Ligjit Nr. 9109, date 17.07.2003, i ndryshuar me Ligjin 9795, date 23.7.2007 dhe Ligjin nr. 10047, date 24.12.2008, Urdherit Nr. 1284/ 3, date 16.3.2005, si dhe Ligjit Nr.91, date 17.9.2012, i cili ka hyre ne fuqi ne daten 17.10.2012, pasi ndryshimet qe i jane bere nenit 11 te ketij ligji per shperblimin e avokatit , nuk jane marre parasysh nga ana e inspektorit tatimor.

Pala paditese ka pretenduar se, ligjet qe permenden me siper kane vepruar ne kohe te caktuar per aq kohe sa kane qene ne fuqi (neni 11), dhe konkretisht kontrolli ndaj tij eshte ushtruar per periudhen 2010, 2011, 2012, 2013. Per periudhen 2010, 2011, deri ne daten 17.10.2012 kur ka hyre ne fuqi Ligji Nr.91, date 17.9.2012, shperblimi i punes si avokat eshte bazuar ne Ligjin 9109, date 17.07.2003 dhe Urdherin Nr. 1284/3, date 16.03.2005, dale ne zbatim te ketij ligji. Ne rastin konkret, pala paditese ka pretenduar se marreveshja ka ekzistuar perderisa ka leshuar fature tatimore TVSH, kupon tatimor.

Pala paditese ka pretenduar se me hyrjen ne fuqi te Ligjit me Nr.91, date 17.10.2012 dhe perderisa Ministri i Drejtesise dhe Kryetari i Dhomes Kombetare te Avokatese nuk kane nxjerre urdher per zbatim te ketij ligji, per tarifat e reja te shperblimit te punes se avokateve, ky ligj eshte i pazbatueshme per periudhen e kontrollit ndaj tij nga data 17.10.2012, deri ne daten 8 nentor 2013. Po keshtu Ligji Nr. 91, date 17.10.2012, nuk ka fuqi prapavepruese per periudhen e kontrollit tatimor 2010, 2011, deri ne daten 17.10.2012.

#### ***Pretendimet e pales se paditur :***

Pala e paditur ka pretenduar se, ne baze te te dhenave te vena ne dispozicion nga vet subjekti eshte kryer kontrolli, ku ka rezultuar se subjekti ka aplikuar tarifa sherbimi per periudhat 2010, 2011, 2012, 2013 me te vogla, se sa eshte percaktuar ne Urdherin nr. 1284/3, date 16.03.2005, ne zbatim te nenit 11 te Ligjit nr.9109, date 17.07.2003, i ndryshuar me Ligjin nr.9795, date 23.07.2007 dhe Ligjin nr. 10047, date 24.12.2008.

Bazuar ne ligjin dhe urdherin e sipercituar dhe referuar kontrollit te dokumentacionit te tatimpaguesit, pala e paditur ka pretenduar se, ne asnje rast ndermjet Z.Qazim Koxhaj, si avokat dhe pales se marre ne mbrojtje nga ana e tij, nuk ka marreveshje per masen e shperblimit per punen e kryer. Ne keto kushte, avokati detyrohet te zbatoje tarifat sipas Urdherit nr. 1284/3, date

16.03.2005 "Per miratimin e tarifave te shperblimit te avokateve per dhenien e ndihmes juridike".

Pala e paditur ka pretenduar se, subjekti "Qazim Koxhaj" ka shkelur nenin 115 te Ligjit Nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.

Pala e paditur ka pretenduar se, tatimpaguesi me hyrjen ne fuqi te Ligjit nr.91/2012, date 27.09.2012, ne te cilin eshte sipercituar "marreveshje me shkrim", nuk ka hartuar marreveshje me shkrim me klientet e mbrojtur ose te perfaqesuar prej tij, duke vepruar keshtu ne kundërshtim me ligjin.

#### *Vleresimi i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore :*

Gjykata ka vleresuar se, pretendimet qe ka parashtuar paditesi nuk perbejne argumente ligjore, si te tilla ato duhet te rrezohen, pasi nga ana e pales se paditur nuk ka rezultuar qe te kemi ndonje tejkalim te procedures ne realizimin e akt kontrollit dhe as tejkalim te dispozitave ligjore qe monitorojne veprimtarine e ketyre zyrove.

Gjykata ka cmuar se, bazuar ne ligj dhe referuar kontrollit te dokumentacionit te tatimpaguesit, ne asnje rast ndermjet Z.Qazim Koxhaj, si avokat dhe pales se marre ne mbrojtje nga ana e tij, nuk ka marreveshje per masen e shperblimit per punen e kryer. Ne keto kushte, avokati detyrohet te zbatoje tarifat sipas Urdherit nr. 1284/3, date 16.03.2005 "Per miratimin e tarifave te shperblimit te avokateve per dhenien e ndihmes juridike".

Njekohesisht gjykata ka cmuar se, paditesi ka shkelur nenin 115 te Ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore Ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.

Gjykata ka cmuar se, subjekti ne asnje rast nuk ka provuar ekzistencen e nje marreveshjeje gojore, detyrim ky i cili i bie per barre provueshmerie pales paditese, mbi te cilin eshte kryer kontrolli, si subjekt tatimor. Pra, nuk mund te pretendohet se eshte zbatuar nje marreveshje, kur nuk ekziston asnje rast provueshmerie midis paditesit, si avokat dhe klientit te tij. Ekzistenca e nje marreveshjeje te tille nuk provohet as me ekzistencen e nje fature tatimore te firmosur prej tij dhe secilit prej klienteve, e cila ne kete rast mund te sherbeje si provueshmeri per ekzistencen e nje marreveshjeje midis paleve me prafimin e kesaj fature dhe likujdimin e saj nepermjet bankes.

Gjykata ka vleresuar se, paditesi edhe me hyrjen ne fuqi te Ligjit nr.91/2012, date 27.09.2012, ne te cilin eshte sipercituar "marreveshje me shkrim", ka vepruar ne te njejten menyre, duke mos

hartuar marreveshje me shkrim me klientet e mbrojtur ose te perfaqesuar prej tij, duke vepruar keshtu ne kundershtrim me kete ligj.

Ne lidhje me pretendimin e pales paditese se nga ana e tij dhe e gjykates jane aplikuar tarifa me te ulta se ato te parashikuara ne Urdherin nr. 1284/3, date 16.03.2005 ne zbatim te nenit 11 te ligjit nr. 9109, date 17.07.2003, gjykata ka cmuar se, ky eshte nje pretendim i cili nuk eshte nje prove ne favor te pretendimeve te tij, pasi shperblimi per cdo avokat ne rastet e perfaqesimeve apo te mbrojtjeve te klienteve ne rastet e caktuara kryesisht nga gjykata, pagesa kryhet ne baze te nje marreveshje midis tij dhe perfaqesuesit te gjykates/gjyqtarit apo kryetarit te gjykates nepermjet vendimit per caktimin kryesisht, te pasqyruar ne procesverbalin e ceshtjes konkrete, e cila sherben si nje prove te ekzistences se marreveshjes.

Per sa me shper, gjykata ka cmuar se, Njoftim Vleresimi nr.906 prot. date 11.03.2014 te nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, si dhe Vendimi nr.7535/4 prot. date 13.05.2014 i Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane eshte i mbeshtetur ne ligj, per rrjedhoje ka vendosur rrezimin e kerkese padise si te pabazuar ne lidh dhe ne prova.

#### *Vleresimi i ceshtjes nga Gjykata Administrative e Apelit :*

*Se pari* gjykata vlereson te evidentoje kompetencen e saj per shqyrtimin e ankimit objekt i ketij gjykimi. Ne referim te nenit 7, nenit 10 dhe nenit 44 te Ligjit Nr. 49/2012, kjo gjykate ka kompetencen lendore dhe funksionale per gjykimin e kesaj ceshtjeje.

*Se dyti* gjykata vlereson te marre ne shqyrtim kushtet e pranueshmerise se ankimit, megjithese kjo eshte bere nga Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore.

Ne nenin 45 te Ligjit nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", parashikohet se:

*"Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve perfundimtare te gjykates administrative per padi me objekt: Kundershtrimin e denimit per kryerjen e kundervajtjeve administrative, me vlere me te vogel se njezet-fishi i pages minimale, ne shkalle vendi; Kundershtrimin e aktit administrativ qe permban detyrim ne te holla, me vlere me te vogel se njezet-fishi i pages minimale, ne shkalle vendi; etj....".*



Me VKM-ne nr. 573, date 03.07.2013 "Per caktimin e pages minimale ne shkalle vendi" eshte vendosur qe prej dates 1 korrik 2013 se: *"1. Paga baze minimale mujore per punonjesit, ne shkalle vendi, qe eshte e detyrueshme te zbatohet nga cdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, te jete 22 000 (njezet e dy mije) leke."*

Duke qene se shuma e percaktuar ne aktin administrativ te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat, objekt kundershimi ne Gjykate eshte me e vogel se 20-fishi i pages minimale (367.705 leke < 440 000 leke) te percaktuar me VKM-ne e mesiperme, Vendimi nr. 1166, date 23.07.2014 i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore, eshte vendim i paankimueshem sipas nenit 45 te Ligjit nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative".

Ne nenin 50/1/a te Ligjit nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", parashikohet se:

*"Gjykata administrative ne dhome keshillimi vendos:*

*a) Mospranimin e ankimit, ne rastet kur ankimi nuk ploteson kushtet e pranueshmerise dhe gjykata administrative e shkalles se pare nuk e ka bere nje gje te tille "*

Ne keto kushte Gjykata Administrative e Apelit cmon se, ndodhet ne kushtet e nenit 45 ne lidhje me nenin 50/1/a te Ligjit nr. 49/2012, dhe duhet te vendose mospranimin e ankimit per shkak se: Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve perfundimtare te gjykates administrative per padi me objekt: Kundershimin e aktit administrativ qe permban detyrim ne te holla, me vlere me te vogel se njezet-fishi i pages minimale, ne shkalle vendi.

#### **PER KETO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar ne nenin 45 dhe 50/1/a te Ligjit nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", i ndryshuar.

## **V E N D O S I**

- Mospranimin e ankimit kunder vendimit te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore Nr. 1166, dt. 23.07.2014.
- U shpall, sot me date 16.06.2016 ne Tirane.

**ANETARE**

**ANETARE**

**KRYESUES**

**FJORALBA PRIFTI**

**BLERONA HASA**

**ARTUR MALAJ**

dv

dv

dv

**Vertetohet njesia me origjinalin**

**Kancelari**

**Leonard Strataj**